

# BULETINI INFORMATIV

Nr. 17, prill - qershor 2018



## “Festa e Traditës” Promovojmë mënyra të reja për krijimin e vendeve të punës

**2**<sup>1</sup> festa lokale, 21 destinacione turistike për të zbuluar Shqipërinë gjatë sezonit veror si pjesë e “Festa e Traditës” – një inisiativë e përbashkët e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të mbështetura nga projekti i financuar nga qeveria zvicerane, Risi Albania.

Festivalet do të zhvillohen nga muaji maj deri në shtator 2018 në 21 fshatra në të gjithë vendin. Ato u përzgjedhën nga 63 propozime në adresë të konkursit që u shpall në mars 2018 për të promovuar ide dhe inisiativa të reja në fushën e turizmit që synojnë:

- Tërheqjen e më shumë turistëve në këto zona;
- Forcimin e bashkëpunimit mes bashkive dhe sipërmarrjeve vendore si operatorë turistikë, agropërpuues, prodhues, fermerë,

përfaqësues të kulturës së zonës etj; - Zgjatjen e sezonit turistik; - Promovimin e produkteve të zonës; - Rritja e të ardhurave nga turizmi; - Rritja e vendeve të punës me një fokus të veçantë të rinjtë dhe grupet e marxhinalizuara.

Këto festivale do të shndërrohen në traditë dhe do të jenë pjesë e kalendarit të aktiviteteve të këtyre fshatrave, duke ndihmuar bizneset dhe operatorët vendas të pozicionohen më mirë gjatë viteve. Këto fshatra janë pjesë e nismës së prezantuar nga qeveria shqiptare “100 fshatrat”.



RISI ALBANIA  
FAZA II (2017-2021)

### OBJEKTIVAT

**1,600**

VENDE TË REJA PUNE

**3,000**

NDËRMJETËSIME



**600**

PUNËSIME

# Festivali i PAN-it në Nivicë

**F**estivali i PAN-it i organizuar në fshatin Nivicë në Tepelenë në 9 qershor 2018 bashkoi fermerët vendas, banorë të zonës së Kurveleshit dhe turistë.

Pjesëmarrësit ndoqën ekspozitën me fotografi dhe veshjet tradicionale të zonës në qendrën e fshatit si dhe morën pjesë në turet me udhërrëfyes në disa nga atraksionet më të bukura të zonës, përfshi edhe kanionet e Nivicës.

Ata shijuan gjithashtu gatimet tradicionale dhe produktet e zonës, muzikën isopolifonike dhe vallet karakteristike si dhe ndoqën konkursin për cjapin më të bukur kushtuar zotit të barinjve sipas mitologjisë greke Pan-it.

Lexoni të plotë shkrimin [KËTU](#)



## Zgjerohet biznesi i prodhimit të vajrave esenciale **Made in Albania**



**N**ë fillim të muajit qershor një pjesë e ekipit të Risi Albania vizitoi kompaninë Mediterranean Export – Imports Albania (MEIA Ltd.), e cila ka qenë partnere e projektit në periudhën 2016-2017.

Synimi ynë ishte të kuptonim një vit pas përfundimit të kontratës me MEIA se si ky bashkëpunim u shndërua në sukses. Shifrat ishin inkurajuese, falë mbështetjes së Risi, MEIA gjeneroi fitime që tanimë janë investuar në distilerinë e re që po ndërtohet në Koplík. Kjo i mundëson kompanisë marrëveshje të qëndrueshme kontraktuale me 240 fermerë të zonës.

Lexoni historinë e plotë [KËTU](#)

## Kërkim mbi nivelet e shërbimit e **këshillimit të karrierës** në universitetet publike dhe private

**R**isiAlbania ka ndërmarrë një kërkim të thelluar për të identifikuar gjendjen aktuale të shërbimeve të këshillimit të karrierës në universitetet publike dhe private në të gjithë vendin, me një vëmendje të veçantë çështjet gjinore dhe përfshirjen sociale. Rezultatet e këtij kërkimi do të shërbejnë si bazë për identifikimin e mundësive për mbështetje nga Risi Albania për shërbime të ndryshme që ofrohen në nivele të ndryshme të këshillimit të karrierës në universitete.

Prezantimi publik i këtyre rezultateve do të bëhet në shtator.



# Nga Call Center drejt industrisë BPO

Emisioni "Exclusive" në televizionin Top Channel transmetoi në fillim të muajit maj dokumentarin mbi të rinjtë që punojnë në call center në Shqipëri dhe potencialin që ka industria e BPO-ve në vend. Andi Stefanllari menaxher ndërhyrjesh sektori TIK pranë RisiAlbania shpjegon mundësitë e shumta që ofron ky sektor.

"Ka ende hapësirë për rritjen e kësaj industrie dhe zgjerimin e shërbimeve dhe mundësitë për të punësuar më shumë të rinj me arsim në fusha të ndryshme si biznes, financë dhe drejtësi të cilët hasin vështirësi për tu punësuar" – thotë Stefanllari.

Të plotë dokumentarin e gjeni [KETU](#)

**RisiAlbania** është një projekt inovativ që synon punësimin e të rinjve, i fokusuar në sjelljen e ndryshimeve sistematike në tregun shqiptar të punës, me qëllim përmirësimin e mundësive për punësim dhe të ardhura për të rinjtë e të rejtat.

**Kohëzgjatja e projektit:**

**Faza I: Nëntor 2013 – Tetor 2017**

**Faza II: Nëntor 2017 – Tetor 2021**

Rr. Ismail Qemali, P18, H.3, Apt. 15  
Tirana, Albania

Tel : +355 (0) 422 48 52

E-mail: [info@risialbania.al](mailto:info@risialbania.al)

[www.risialbania.al](http://www.risialbania.al)

## ClubFM radio sjell programin e ri "Rruga drejt suksesit"

**M**os e humbisni programin më të ri radiofonik "Rruga drejt suksesit" i cili transmetohet çdo të martë dhe të enjte në orën 10.00 ditë në valët e radios ClubFM!

Ky edicion special, pjesë e emisionit "Makinë me dy timona", sjell informacione aktuale mbi orientimin drejt karrierës dhe tregut të punës në një mënyrë tërheqëse përmes humorit. Intervistat me të rinj që kanë zgjedhur rrugë të suksesshme përgjatë karrierës së tyre ndiqen me shumë interes nga audienca.



## Drejt krijimit të portalit zyrtar të turizmit, qarku Gjirokastrë

**R**isiAlbania mbledhi së bashku në Gjirokastrë tur-operatorë, biznese, përfaqësues të qeverisë vendore dhe akademisë, të cilët ranë dakord të krijojnë dhe të kontribuojnë në menaxhimin e një trupi që do të jetë përgjegjës për krijimin dhe menaxhimin e portalit zyrtar të turizmit për Qarkun e Gjirokastrës.

"Ky portal është mjeti i duhur që do të na afrojë me njëri-tjetrin dhe të punojmë së bashku për një qëllim të përbashkët, promovimin e Gjirokastrës si destinacion turistik" – tha Sadi Petrela i Fondacionit Gjirokastra. Risi i njohu të pranishmit me praktikën dhe modelet më të mira në vend dhe jashtë tij, duke synuar të nxisë krijimin e hapave të parë për krijimin e portalit të Gjirokastrës, një instrument për rritjen e informimit të turistëve. Kryetarja e bashkisë Znj. Zamira Rami përshëndeti takimin dhe ofroi mbështetjen maksimale të bashkisë për këtë iniciativë, e cila do të menaxhohet nga aktorët vendorë dhe do të mbështetet nga Risi Albania.



## AKTIVITETET E ARDHSHEME

3 korrik 2018

**Workshop-i i parë i transferimit të teknologjive të reja në Shqipëri "SAP HANA"**

5 korrik 2018

**Prezantimi i rezultateve të studimit "Vlerësimi i multiplikatorëve të punësimit në sektorët e ekonomisë"**

shtator 2018

**Kërkim mbi nivelet e shërbimeve dhe këshillimit të karrierës në universitetet publike dhe private**